



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.24 Date 15.09. 2010

Per:

**Ndryshim Leje Shfrytezimi (Pezullim) Nr.07 date 09.05.2008
per subjektin " Guri Simoni shpk ".**

Ne mbeshtetje te nenit 8 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 "Per Rezervat Ujore" dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit "Mbi proçedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve", Vendimit te KKKU-se nr.01 date 21.06.2006 "Per reduktimin e shfrytezimit te inerteve", nr.01 date 13.01.2010 "Per ndalimin e dhenies se Lejeve perkohesisht per shfrytezim inertesh", AUB Mat ka ushtruar kontrole te vazhdueshme ndaj subjekteve te lejuara per shfrytezim te inerteve. Gjithashtu me propozimin e AUB Mat, KBU Mat ka marre vendime te ndermjetme per te paralajmeruar keto subjekte per te respektuar kushtet e lejes. M.M.P.A.Ujrave ka konstatuar keto shkelje edhe nga kontrollet qe ky dikaster ka ushtruar ne lumenjte Mat dhe Fan, duke terhequr vemendjen disa here zyrtarisht per respektimin e kushteve te lejes nga subjektet e licensuara per te cilat eshte informuar edhe KBU Mat. **Subjekti "Guri Simoni shpk" me vendndodhje ne Rubik nuk ka sistem reperizimi te karrieres, Nuk ka paraqit tek AUB-ja projektin e shfrytezimit dhe reabilitimit vjetor. Eshte debitor ne shumen 12375 lek.** Keto shkelje bien ndesh me pikat 1, 7 te lejes se shfrytezimit dhe ky subjekt eshte ne kushtet e pezullimit se lejes se shfrytezimit. Gjithashtu bie ne kundersizim me detyrat qe parashtron Plani Menaxhimit Basenit Mat per ruajtjen e biodiversitetit te lumit Mat. Eshte ne kushtet e pezullimit te Lejes. Per sa me siper Keshilli Basenit Mat,

V e n d o s i:

1. Ndryshimin e Lejes Shfrytezimit (pezullimin) per subjektin "Guri Simoni shpk",
2. Ngarkohet AUB Mat per zbatimin e ketij vendimi. Te bashkpunoje me INUK, ARM dhe Grupin Task-Force per ndalimin e shfrytezimit te inerteve ne zonen e ndaluar.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI

KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI